URDHËR
Nr. 594, datë 31.7.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 1.8.2024 deri më datë 10.8.2024.
2. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Roland Kristo, nga data 11.8.2024 deri më datë 18.8.2024.
3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Enio Civici nga data 19.8.2024 deri më datë 27.8.2024.
4. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ose personi që ushtron detyrat e tij, në rast mungese.
6. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.
7. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet:
- zëvendësministri z. Arian Jaupllari;
- zëvendësministri z. Roland Kristo;
- zëvendësministri z. Enio Civici.

8. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
9. Ky urdhër hartohet në 5 (pesë) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1(një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 3 (tre) për zëvendësministrat, sipas pikave 1, 2 dhe 3.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj